

VENDIM
Nr. 795, datë 24.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE TË APLIKIMIT E TË SHQYRTIMIT, TË MËNYRËS SË PËRZGJEDHJES SË PROJEKTEVE DHE TË PROCEDURAVE TË FINANCIMIT NË FORMË TRANSFERTE PËR VEPRIMTARI TË PROPOZUARA NGA KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR, OLIMPIKU SPECIAL SHQIPTAR, FEDERATAT JOOLIMPIKE DHE FONDACIONET SPORTIVE, ME THEMELUES INSTITUCIONET PUBLIKE PËRGJEGJËSE NË FUSHËN E SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka për objekt përcaktimin e kriterëve, të procedurave të aplikimit e të shqyrtimit, të mënyrës së përzgjedhjes së projekteve dhe të procedurave të financimit në formë transferite nga ministria përgjegjëse për sportin për veprimtaritë e propozuara nga organizatat sportive, si më poshtë vijon:

- a) Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;
- b) Olimpiku Special Shqiptar;
- c) federatat joolimpike;
- ç) fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit.

2. Organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

- a) të kenë fushë veprimtarie të ngjashme me projektin që po aplikojnë;
- b) të kenë zhvilluar Kampionatin Kombëtar dhe Kupës së Shqipërisë në vitin paraardhës, në rastin e Federatave Joolimpike, dhe Lojërat Olimpikë Speciale, në rastin e Olimpikut Special Shqiptar;
- c) të kenë ndikim në masivizimin e sportit dhe përfshirjen e të rinjve në aktivitetet sportive, zhvillimin e talenteve dhe përmirësimin e rezultateve sportive, promovimin e barazisë gjinore, përfshirjen e femrave e të personave me aftësi ndryshe, promovimin dhe mbështetjen e sportistëve të nivelit të lartë.

3. Organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, paraqesin projektpropozimin, të miratuar paraprakisht nga organi ekzekutiv, të shoqëruar me vendimin përkatës dhe me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) vendimet e asamblesë vjetore për vitin paraardhës të aplikimit dhe vendimet e asamblesë së fundit zgjedhore, të zhvilluar në respektim të ciklit olimpik, në rastin e federatave sportive;
- b) kopjen e statutit dhe/ose të vendimit të gjykatës për regjistrimin e saj, sipas legjislacionit në fuqi;
- c) dokumentacionin që vërteton regjistrimin si person juridik, sipas legjislacionit në fuqi;
- ç) urdhrin e ministrit përgjegjës për sportin për miratimin e statutit dhe ndryshimeve të tij;
- d) bilancin financiar të miratuar sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) të dhënat e llogarisë bankare të nivelit të dytë të dedikuar;
- e) raporte financiare periodike për fondet publike të akorduara nga ministria përgjegjëse për sportin.

4. Formulari i aplikimit të projektit përcaktohet çdo vit me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin dhe përmban të dhënat, si më poshtë vijon:

- a) projektpropozimin e plotë;
- b) planin e detajuar dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve;
- c) buxhetin e detajuar dhe të argumentuar për realizimin e aktiviteteve;
- ç) konfirmimin për bashkëfinancimin e projektit të propozuar, nëse ka;
- d) marrëveshjet me partnerë të tjerë, që janë pjesë e zbatimit të projektit.

4/1. Në rast se paraqitet më shumë se një projektide, duhet të paraqitet buxhet i veçantë për secilin projekt.

5. Prioritetet për përzgjedhjen e projekteve përcaktohen çdo vit me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin, shoqëruar me formularin e aplikimit të projektit.

6. Thirrja për paraqitjen e projektpropozimeve hapet çdo vit brenda muajit shkurt dhe qëndron e hapur, sipas afatit të përcaktuar, me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, struktura përgjegjëse, brenda 7 (shtatë) ditëve, nëse konstaton parregullsi, njofton aplikuesit, duke i caktuar afatin 5-ditor për plotësimin e parregullsive.

7. Shqyrtimi, renditja dhe përzgjedhja e projektpropozimeve nga ministria përgjegjëse për sportin bëhet sipas procedurës së mëposhtme:

a) Ngrihet komisioni i vlerësimit të aplikimeve të bëra nga organizatat sportive, i cili vlerëson projektet, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij vendimi;

b) Komisioni i vlerësimit harton për secilin projektpropozim raportin e arsyetuar dhe propozimin për financim;

c) Komisioni i vlerësimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga ngritja e tij, i njofton aplikuesve renditjen përfundimtare. Aplikuesit mund të ankimojnë vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit brenda 5 (pesë) ditëve te ministri përgjegjës për sportin. Nëse pas përfundimit të afatit të ankimit administrativ, rezulton se nuk është paraqitur asnjë ankim administrativ, komisioni i vlerësimit i paraqet ministrit renditjen përfundimtare të aplikuesve, shoqëruar me vlerat financiare.

Shqyrtimi i ankimit kryhet nga komisioni i shqyrtimit të ankesave, i cili përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) anëtarë. Ky komision ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit administrativ, komisioni i paraqet ministrit vendimin për shqyrtimin e ankesave dhe renditjen përfundimtare.

8. Tavanet e financimit për financimin në formë transferte për veprimtari të propozuara nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar, Olimpiku Special Shqiptar, federatat joolimpike dhe fondacionet sportive, me themelues institucionet publike përgjegjëse në fushën e sportit, përcaktohen në përputhje me fondin e miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, në programin e zhvillimit të sportit. Këto organizata financohen dhe monitorohen nga ministria përgjegjëse për sportin, sipas procedurave të mëposhtme:

a) strukturat përgjegjëse për financat, në ministrinë përgjegjëse për sportin, kryejnë kreditimin e fondeve buxhetore për organizatat sportive;

b) strukturat e sportit, në ministrinë përgjegjëse për sportin, sipas rregullores së brendshme, monitorojnë përdorimin e fondeve publike nga përfituesit e grantit/transfertës gjatë vitit ushtrimor;

c) organizatat sportive të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, duhet të bëjnë transparente për anëtarët e tyre ndarjen e të gjitha fondeve të përfituara në vitin korrent, si dhe të publikojnë këtë informacion në *website*-t e çdo organizate. Drejtoria përgjegjëse për programet e zhvillimit të sportit monitoron zbatimin e këtij detyrimi.

9. Fondet e miratuara alokohen nga ministria përgjegjëse për sportin në llogaritë bankare të dedikuara të nivelit të dytë të përfituesve. Përfituesit e fondeve publike raportojnë periodikisht, çdo 6 (gjashtë) muaj, për zbatimin e projektpropozimeve të financuara, për të siguruar transparencë, monitorim të rezultateve dhe përputhshmëri me objektivat dhe planin e miratuar të aktiviteteve.

10. Monitorimi i projekteve të realizuara nga federatat sportive dhe fondacionet e themeluara nga ministria përgjegjëse për sportin kryhet nga struktura përgjegjëse për sportin.

11. Monitorimi për mbikëqyrjen e realizimit të mbështetjes financiare të KOKSH-it kryhet nga grupi i punës, i caktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin. Përbërja dhe detyrat e grupit të punës përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për sportin.

12. Në rastet e projekteve me interes të veçantë publik, të cilat lidhen me zhvillimin kombëtar të sportit, përfshirjen sociale, edukimin fizik të të rinjve, apo nisma të tjera, që kanë impakt të drejtpërdrejtë në komunitet, të paraqitura nga organizatat sportive, të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, të paraqitura jashtë afateve të përcaktuara, ministria përgjegjëse për sportin, bazuar në fondet buxhetore të disponueshme ose ato të vëna në dispozicion nga ministria përgjegjëse për financat, mund të shqyrtojë dhe të miratojë financimin e këtyre projekteve. Në këtë rast, aplikuesit plotësojnë kriteret e parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, dorëzojnë dokumentacionin shoqërues të parashikuar në pikën 3, të këtij vendimi, së bashku me projektpropozimin e plotë, planin e detajuar dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve, buxhetin e detajuar dhe të argumentuar për realizimin e aktiviteteve, konfirmimin për bashkëfinancimin e projektit të propozuar, nëse ka, dhe marrëveshjet me partnerë të tjerë, që janë pjesë e zbatimit të projektit.

13. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe organizatat sportive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku